

EPPC Albania & Kosovo, kërkon Menaxher të Pijeve dhe Ushqimit, për klientin e saj, që operon në Industrinë e Hoteleri-Turizmit në Ulqin (Mal i Zi).

Qëllimi kryesor i punës:

- Menaxhon dhe koordinon departamentin e pijeve dhe ushqimit si dhe mbikëqyr rregullisht çdo shërbim në zonën e bar-eve dhe restoranteve;
- Kujdeset që të ketë produktet më të mira me qëllim përmirësimin e cilësisë si dhe mban komunikimin me furnitorët si brenda dhe jashtë vendit;
- Zhvillon dhe menaxhon planet dhe veprimet financiare të departamentit ushqimor duke mbajtur nën kontroll menaxhimin e kostove;
- Mbikëqyr dhe menaxhon operacionet ditore të punonjësve, kujdeset në kryerjen e përgjegjësive nga ana e tyre në kohë dhe me efektivitet duke i motivuar dhe trajnuar sipas nevojave;
- Trajton ankesat e klientëve dhe kujdeset që çdo problem apo pakënaqësi nga ana e tyre të kalojë për zgjidhje në departamentet përkatëse;
- Siguron pajtueshmërinë me të gjitha rregullat e higjienës dhe shëndetit me qëllim përmbushjen e standardeve të cilësisë.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- E preferueshme të jetë nga zona veriore e Shqipërisë ose nga Kosova;
- Të zotërojë shumë mirë **gjuhën Shqipe dhe Malazeze**, (*Anglishtja përbën avantazh*);
- Të jetë i diplomuar në degët e Hoteleri-Turizmit ose Menaxhim/Administrim Biznes;
- **Përvojë e mëparshme pune në sektorin ushqimor/pijeve, në bare, restorante, hotele;**
- Aftësi të mira organizative, planifikuese dhe të menaxhimit të stafit;
- **Gadishmëri për të punuar në Ulqin/Mal i Zi, (veçanërisht gjatë sezonit turistik).**

Të dhënat:

Pozicioni:	Menaxher i Pijeve dhe Ushqimit;
Vendndodhja:	Ulqin (Mal i Zi);
Orari:	48 orë në javë;
Kontrata:	Sezonale (<i>Prill – Tetor</i>), me mundësi rinovimi;
Pagesa:	800 EURO net/muaj;
Aplikimet mbyllen:	15.12.2016.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj me fotografi në Anglisht duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail-it: recruitments@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.